

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 163, Maj 2017

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

SHKOLLA E PREKALIT PO MBUSHE NJË SHEKULL

2

- FALIMINDERIT AT'SHTJEFËN GJEÇOVI PËR DHURATËN
DRITËDHËNËSE! -

Shqiptarët në fushën e trashigimisë arsimore kanë qenë një popull i shkretë, i padije, të shpërndarë, të izoluar dhe në grindje njeri me tjetrin, pa kurrfarë unifikimi shtetëror dhe me ndërgjegje foshnajak kombëtare. Ja si e përshkruante revista prestigjioze kulturore "Rilindja" e Korçës e datës 2 nëntor 1935, fyturën e vërtetë orientale të Shqipërisë: "100 mijë qytetarë, s'dinë asgjë për 900 mijë fshatarë, 500 mijë gegë nuk dinë asgjë për 500 mijë toskë, 300 mijë kristian nuk dine asgjë 700 mijë musliman"! Më të vjetrit e rajonit, por më të vonuarit në shkrimin e gjuhës së vet, më të vonuarit në njësimin e alfabetit, në hapjen e shkollave në gjuhën amtare, të fundit shtet - formues të Ballkanit. Një popull një milion me 900 mijë analfabet ishte gjendja jonë arsimore që trashiguan deri në vitin 1944.



VËLLEZËRIT QAFARENA – VOLEJBOLLISTË TË SHQUAR

Kontributi i Dukagjinave në zhvillimet historike, në art, në kulturë, në sport e të tjera, ka qenë më i madh se i çdo krahine tjetër e vendit, duke i dhënë Atdheut figura të shquara me përmasa kombëtare si: luftëtar, artist, aktor, poet e shkrimtar, muzikant, piktor, teolog dhe sportist anëtar të ekipeve kombëtare ku të gjithë kanë bërë që Dukagjini të vlerësohet me urdhrin "NDERI I KOMBIT". Për ta është shkruar shumë e dhënë vlerësimin që meritojnë, por mbetet ende shumë për të bërë, sepse ka mjaft të tjerë me shumë kontribut dhe që kanë mbete në hije duke mos marre veshimin që meritojnë e promovuar vlerat që kanë.

3

Malësia e Madhe në antikitet përfaqsohet nga stacionet Çinna dhe Berzumno

Duke ju referuar fakteve historike si dhe gjetjeve arkeologjike të deritanishme është bërë e mundur të përcaktohet qartazi se ku shtrihen trojet etnike shqiptare me prejardhje ilire, pjesë e së cilës është edhe Malësia e Madhe. Me përcaktimin e kufijve politik të vitit 1913 hapësira territoriale e Malësisë së Madhe u nda në dy nënshtetësi, ku njëra pjesë gjendet në skajin veriperëndimor të Republikës së Shqipërisë dhe pjesa tjetër shtrihet në skajin Jug-Lindor nën Malin e Zi. Kjo ndarje brutale territoriale përveç pasojave sociale-ekonomike ka pasur edhe shumë anë të tjera negative siç janë politiko-kulturore, mbi të cilat kanë ndikuar drejtpërsëdrejti politikat e qeverive përkatëse, gjithashtu negativisht kane ndikuar edhe mbi studimet e mirëfillta shkencore, ku përcaktohen vlerat sociale kulturore të krejt Malësisë së Madhe duke bërë që ato të kenë mangësi, njëanshmëri, si dhe të jenë të pa plota, për aq kohë sa nuk janë gjithëpërfshirëse në përcaktimet e veta. Studimet më të shumta mbi këtë territor dhe banorët e saj, na vijnë që nga periudha e mesjetës e në vazhdim, gjë që lidhet me shumëllojshmërinë e burimeve të shkruara si dhe me vete faktin se ngjarjet historike janë më të fresketa.

6

Përkujtohet revolta e Spaçit

Me 21 Maj 2017, ditën e diele, u organizua në Spaç të Mirditës ceremonia përkujtimore e Revoltës Antikomuniste të vitit 1973, e cila shpërtheu mes të dënuarve në Burgun e Spaçit. Është i pesti vit radhazi që kjo veprimtari organizohet nga Komisioni Drejtësi dhe Paqe i Shqipërisë, ent i Kishës katolike, me të cilin Shoqata Atdhetare "Dukagjini" ka traditë të hershme bashkëpunimi. E zhvilluar gjatë paradites në mjediset ku dikur ndodhej burgu famëkeq i Spaçit, në ceremoni morën pjesë rreth 200 persona. Pati pjesëmarrës nga shumë organizata ...

5

100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

SHKOLLA E PREKALIT PO MBUSHE NJE SHEKULL

- FALIMINDERIT AT'SHTJEFËN GJEÇOVI PËR DHURATËN DRITËDHËNËSE! -



PRELE MILANI

Shqiptarët në fushën e trashigimisë arsimore kanë qenë një popull i shkretë, i padije, të shpërndarë, të izoluar dhe në grindje njeri me tjetrin, pa kurrfarë unifikimi shtetëror dhe me ndërgjegje foshnajakë kombëtare. Ja si e përshkruante revista prestigjioze kulturore “Rilindja” e Korçës” e datës 2 nëntor 1935, fytyrën e vërtetë orientale të

Shqipërisë: “100 mijë qytetarë, s’dinë asgjë për 900 mijë fshatarë, 500 mijë gegë nuk dinë asgjë për 500 mijë toskë, 300 mijë kristian nuk dine asgjë 700 mijë musliman”¹ Më të vjetrit e rajonit, por më të vonuarit në shkrimin e gjuhës së vet, më të vonuarit në njësimin e alfabetit, në hapjen e shkollave në gjuhën amtare, të fundit shtet - formues të Ballkanit. Një popull një milion me 900 mijë analfabet ishte gjendja jonë arsimore që trashiguam deri në vitin 1944.

“Sundimi pesë shekullor i Turqisë, një sundim nga më të zezët, na ka shtuar të metat e vjetra dhe na ka pakësuar virtytet: Turku na mësoi edhe një herë më përtac, e më harbutarë...”²

Atëherë kur Shqipëria qe e roberuar, gjuha shqipe dhe shkolla shqipe qe e ndaluar, Naimi ynë i madh këndonte shqip dhe me vargjet e tija të mbushura me patriotizëm, u bënin thirrje shqiptarëve për të mësuar gjuhën shqipe.

Po të mësojmë / E të këndojmë, / Mirë do rrojmë / Në ketë jetë / Se dituria dhe mirësia / njeriun e çquan, / Mendja ndritohet, / Zemra qarohet / Shpirti madhohe

Në kohën kur në malet tona mbizotëronte errësira e pafund mesjetare,

gjendja e mjeruar si më ska, patrioti, etnografi, arkeologu, historiani, kleriku dhe fatosi i arsimit shqip At Shtjefën Gjeçovi për herë të parë në mes të këtyre maleve ndezi një pishë për të ushqyer bijtë e maleve të leknisë me dritën e shkollës shqipe. Në një dhomë të vogël të një shtëpie të vjetër, ku banonte vetë At’ Shtjefën Gjeçovi, hapi ne Theth e Prekal dy shkollat e para në gjuhën shqipe, në ato vise të banuara prej shumë shekujsh nga filizat më të spikatur të tharmit iliro - arbëror.

Në letrën që i dergonte Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit në Shkodër, Gjeçovi shkruante:

Prekal, 18 shtator 1917

... Kam nderin me ju shkruar me ju parashtruar... . do pika mi msojtorën t’re t’kti katundi, t’Prekalit, n’flamur të Shoshit, tuj e lutun zotninë tuj qi t’nini mirësinë me i marrun në kujdes.

Me 17 t’Vjeshtës parë 1917, e fillova mësimin e do ta vijoj me të njajtin qellim t’përhershëm t’em me i vlejhtë masës së re të Kombit t’onë me dëshirë qi t’ përparojë kah zhvillimi i mendes e shijës e kah zhvillimi i jetës shoqnore e gjytetare. Mësimi ka me u dhanë dy herë në ditë, para dite djemve e vajzave mbas dite. Numri i

nxansve asht ky: Djem 26 e varza 11.

Mësimi ka me u dhanë m’një odë të ksaj qele, oda asht e vogël dhe e ngushtë, por se do të bazohna në nevojat e kohës. Për kah lënda e një msojtores, për gjithçka jena mangut, por se unë nuk e t’oj (?) Zotnien tuj për teprina, vetëm për do sende të domosdoshme si janë libra, shkumsa, bukurshkroje, a ma mirë tabela t’vogla për t’vumit për fije të fëmijve, kah shkrimi e t’ndo i send tjetër qi t’u marrë mendja zotnisë suej se duhet për mesojntore.

N’shpnesë se si po fillohet mësimi me qellim t’ mirë, ashtu ka me shkue mbarë, po kam fatin me u nanshrue Gjeçovi³

Një kërkesë të ngjashme Gjeçovi do i dërgonte edhe konsullatës austro-hungareze në Shkodër, por nuk arriti të merrte asgjë përveç se zhgënjimit të rradhës. Shkolla e parë e Prekalit qe jetëgjatë aq sa qëndroi Gjeçovi në Prekal deri në fillim të janarit 1919,

kur u transferua në Troshan. Shkolla e Gjeçovit ishte si një flakerimë drite, që kaloi vetetimthi në qiellin e maleve plot re të Dukagjinit. Ndriçimi i saj u shua shpejt nga errësira e netëve të gjata që pasuan, por gjithsesi mbi atë gur themeli, mbi të cilën pas Luftës së dytë Botërore do të ngriheshin shkollat kudo në fshatrat e Dukagjinit. Brenda një viti kalendarik nga shkurti në shtator të 1917 At’ Shtjefën Gjeçovi, njeriu që me dorën e djathtë të bekuar prej vete Zotit mbledhi Kanunin e Leke Dukagjinit, (pasaportën zakonore kombëtare) beri atë që se bëri dot deri atëherë as një qeveri shqiptare as e huaj, i dhuroj maleve të Dukagjinit dy motra binjake, dy shkollat e para shqipe.

Në nderim dhe me mirënjohje të thellë të këtij personalitet poliedrik të kulturës sonë të martirizimin, në emër të idealeve më eprore kombëtare mendoj se është rasti më i mirë, për të bërë autokritike për vonesën dhe nga ana Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” t’i propozohet strukturave kompetente që njëra nga këto dy shkolla të mbaje emrin e pa vdekshëm “Shtjefën Gjeçovi”.



1 “Rilindja” e Korçës, 2 nëntor 1935

2 Mit’hat Frashëri “Plagët tona”, fq. 15

3 A. Q H, fondi 58, dosja 21 dokumenti 14

VËLLEZËRIT QAFARENA – VOLEJBOLLISTË TË SHQUAR

Kontributi i Dukagjinase në zhvillimet historike, në art, në kulturë, në sport e të tjera, ka qenë më i madh se i çdo krahine tjetër e vendit, duke i dhënë At-dheut figura të shquara me përmasa kombëtare si: luftëtar, artist, aktor, poet e shkrimtar, muzikant, piktor, teolog dhe sportist anëtar të ekipeve kombëtare ku të gjithë kanë bërë që Dukagjini të vlerësohet me urdhrin “NDERI I KOMBIT”. Për ta është shkruar shumë e dhënë vlerësimin që meritojnë, por mbetet ende shumë për të bërë, sepse ka mjaft të tjerë me shumë kontribut dhe që kanë mbete në hije duke mos marrë vlerësimin që meritojnë e promovuar vlerat që kanë.

Shumë të suksesshëm në sektorët që militojnë ka edhe sot dukagjinase, duke përfshirë edhe sportin, ku padyshim ndër më të suksesshmit janë sot vëllezërit Qafarena – NIKOLINI e ANTONI - nga fshati Gimaj i Shalës, me banim në Shkodër, volejbollist të ekipit të “Vllaznisë” e atij kombëtar prej disa vitesh. Edhe fshati Gimaj, si gjithë Dukagjini, ka nxjerrë sportist me përmasa kombëtare e ndërkombëtare si: nën kampionin e Evropës në mundje, Ndue Njemza; basketbollistin më të mirë të Shqipërisë e Ballkanit për kohën e vet, Renato Radoja e të tjerë. Pa dyshim që vargut të gjatë të sportistëve dukagjinase në disiplinën të ndryshme i janë bashkëngjit edhe vëllezërit Qafarena, për të cilët do të flasim pak më gjatë. Janë nga një familje me emër e Gimajve dhe e Shalës, që është shquar për mençuri dhe përkrahës të progresit. Janë nipa të Ndue Vatës nga Pecajt e Shalës, familja e të cilit ka bërë emër në të gjithë Shqipërinë duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin dhe progresin e vendit tonë.

30 vjeçar Nikolin Qafarena ka mbaruar universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, fakulteti bio-kimi dhe është në përfun-

dim të fakultetit të edukimit fizik. Që në vitet e gjimnazit është pjesëtar i ekipit të volejbollit të “Vllaznisë” dhe tash 5 vjet anëtar i ekipit kombëtar. Punon



mësues bio - kimie në shkollën 9 vjeçare Mali i Jushit. Nga kontaktet me drejtuesit e shkollës dhe kolegët dëgjon fjalët më të mira për te, si mësimdhënës. Ka rezultate të larta në procesin mësimor - edukativ duke aplikuar metoda bashkëkohore. Është shumë i dashur dhe i komunikueshëm me koleg, nxënës e prind, i cili me punën dhe sjelljen e tij ka fituar respektin e të gjithëve. Me shkuarjen e tij në atë shkollë kanë marrë gjallëri veprimtaritë jashtëshkollore, sidomos ato sportive. Si në sport ashtu edhe në punë është fjalëpakë e punë shumë. Në dekadën e fundit ka dhënë një kontribut të madh në sukseset e ekipit të volejboll-

lit të “Vllaznisë” duke qenë gjithnjë titullar. Është shumë kontribuues edhe në ekipin kombëtar të volejbollit si një ndër më aktivët.

Vëllai i vogël (në moshë) Antoni, këto ditë bën 20 vjet. Në moshë kaq të re, asnjë volejbollist shqiptar nuk ka bërë kaq histori në sport. Talent i lindur dhe i formuar si volejbollist me punë dhe vullnet të hekurt që 16 vjeç me ekipin e parë të “Vllaznisë”. 17 vjeç anëtar i ekipit kombëtar të volejbollit. 18 vjeç është shpallur volejbollisti më i mirë i vendit tonë. Duke parë cilësitë e tij të jashtëzakonshme, ka qenë jo vetëm titullar i ekipit kombëtar, por është marrë edhe si përforsim nga ish-ekipit kampion “Studenti” në veprimtaritë ndërkombëtare, që me talentin e tij ka fituar admirimin e shikuesve në shumë qytete të Evropës. Në turneun e Maqedonisë për kupën e “Flamurit” në nëntorin e kaluar, jo vetëm që ishte kontribuues kryesor në fitimin e kupës nga ekipi i “Vllaznisë”, por u shpall volejbollisti më i mirë i turneut duke marrë vlerësimet maksimale nga specialistët dhe menaxherët e volejbollit. Vazhdon studimet e larta në Universitetin e Shkodrës, dega edukim fizik, i cili bën diferencën edhe si student korrekt e shembullor.

Duke u nisur nga cilësitë e tij, Antoni është kërkuar nga disa klube Evropiane për ta pasur në gjirin e tyre. Ai ka zgjedh klubin e bundesligës gjermane “TV BUHL”, me të cilin ka nënshkruar një kontratë 3 vjeçare. Të gjithë sportdashësit shkodran u gëzuan që ekipi i volejbollit të “Vllaznisë” u shpall kampion i Shqipërisë për herë të parë në historinë e tij, ku për këtë sukses meritë kryesore kanë vëllezërit Qafarena si titullar në gjashtëshen e parë duke qenë protagonist në çdo cep të fushës si shutër të papërballueshëm nga kundërshtari, neutralizues të sulmeve të ekipit tjetër dhe

në shërbime cilësore ku me lojën e tyre ngritën peshë një pallat sporti. Kjo cilësi loje bëri që pallati i sportit të mbushej plot e përplot si asnjëherë tjetër. Këta 2 sportist të shquar edhe në jetë rrezatojnë mirësjellje dhe edukatë qytetare duke dhënë një shembull të shkëlqyer se si duhet të integrohen banorët e rinj në jetën urbane duke vërtetuar se nuk ka rendësi nga vjen e sa kohë ke në qytet, por sa vlera qytetare ke.

Nuk kanë vështirësi në komunikim ngado që të shkojnë, sepse zotërojnë disa gjuhë kryesore evropiane. Për formimin dhe edukimin e këtyre vëllezërve merite kryesore kanë prindërit e tyre shembullor, ekonomisti i suksesshëm Gjon Qafarena dhe mësuesja e palodhur Leze Qafarena, të cilët kanë bërë që fëmijët t’i kenë krejtësisht shëmbëlltyrë të tyre.

Kontributi i dukagjinase në sport në të gjitha disiplinat, që nga 1945 ka qenë shumë i madh në nivel kombëtar duke filluar që nga anëtarët e përfaqësueses së futbollit të vitit 1946 e ndër vite në vazhdim në futboll, basketboll, mundje, atletikë, boks, qitje e të tjera, vlerat e të cilave janë promovuar nga shoqata “Athletare Dukagjini” nëpërmjet gazetës “Dukagjini”, librave të shkruar për ta dhe sensibilizimin e organeve të pushtetit vendor e qendror. Edhe sot të rinjtë dukagjinase janë një fidanishte që po furnizon të gjitha ekipet zinxhirë të klubit shumësportësh “Vllaznia” në të gjitha disiplinat e sportit, të cilët shkëlqejnë në sajë të përkushtimit dhe vitalitetit të tyre, por kanë nevojë që në të ardhmen me i inkurajuar nëpërmjet promovimit të vlerave të tyre në mediat e shkruara e ato vizive. Ata duhet të kenë si shembull frymëzimi vëllezërit Qafarena, të cilëve ju urojmë nga zemra suksese të mëtejshme, duke e ngrit akoma më lart emrin e Dukagjinit “NDERI I KOMBIT” edhe në fushën e sportit.

PRELË SHYTANI

LIBRI “KOD” ME AUTORE MONIKA SHOSHORI STAF

Pasditen e datës 17 mars 2017, në mjediset e Bibliotekës “Marin Barleti”, u zhvillua ceremonia e paraqitjes së librit “Kodi”, me autore Monika Shoshori Stafa, gazetarë, e organizuar nga Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër, zoti Gjergj Leqeja në bashkëpunim me Drejtorin e Bibliotekës, zotin Gjovalin Çuni. Me këtë rast morën fjalën Gjovalin Çuni, zoti Gjergj Leqeja, si kontribuues e përgatitjes dhe zhvillimit të kësaj ceremonie. E mori fjalën shkrimtari e përkthyesi, zoti Zija Vuka, dhe kryetari i shoqatës së shkrimtareve të Shkodrës, zoti Skënder Temali. Pastaj u kalua në bashkëbisedim me autoren, zonjën Mika.

Korespondenti i gazetës “Dukagjini”



15 vjetori i Muzeut Etnografik “Ivezaj”

Me datën 1 maj 2017, Muzeu Etnografik “Ivezaj”, në Lekaj, të Komunës Tuz, kishte 15 vjetorin e themelimit të tij. Një pjesëmarrje e madhe, nga Shkodra, Malësia e Madhe në të dy anët e kufirit, gazetar e media, artist, shkrimtar, poet, historian, diplomat, anëtar të Shoqatës Atdhetare “Malësia”, të Shoqatës “Malësia e Madhe – Nderi i Kombit”, nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, dhe vepërimtar të fushave të ndryshme.

Nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, ishte një grup, Ndue e Vera Sanaj, Gjergj Leqeja, Prele Shytani, Lazer Kodra, Aleks Dushi, Roza Pjetri, Anton Kosteri, Lulash Brigja e Vuksan Sokoli, Mhill Prroni e Pal Lera.

Një pritje mjaft me dashamirësi, ashtu siç e ka në traditë malësori, me shumë bujari, me shumë mirëseardhje, që në fillim nga Shtjefen Ivezaj.

Me këtë rast shumë mund të flitet për këtë muze, se në atë godinë një katesh prej katër dhomash, gjendet një thesar me shumë vlera, që me falënderime dhe mirënjohje të pafundme për punën dhe nderin që i ka bere Malësisë në tërësi e çdo malësori në veçanti, por dhe shqiptarisë në tërësinë e saj. Mbledhja e këtij fondi objektiv e ruajtja me shume fanatizëm, duke e kthyer atë në koleksione me shumë vlera për kulturën tone kombëtare, të ekspozuar ne faqe murale, duke marre forme, në parametrat e një muzeu modest, në të cilën pasqyrojnë periudhën mesjetare e në vijim. Madje dhe shumë më të hershme, që cilësuan mjaft nga ata që përshëndeten në këtë 15 vjetor.

Prandaj shumë personalitete dhe adhurues të artit dhe kulturës nga Malësia e Madhe dhe Tuzi, nderuan dhe vlerësuan këtë Muze, që është një pasuri kombëtare.

Ivezaj, me familjen e tij, kane një meritë të madhe e të paçmuar për dashamirësinë që kane treguar për hapësirën e Malësisë së Madhe dhe shqiptarisë. Me këtë rast pati mjaft përshëndetje deri dhe Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Malit të Zi, zoti Ernal Filo.

Përshëndeti kryetari i Shoqatës Atdhetare “Du-

kagjini”, Ndue Sanaj. Me këtë rast ky Muze, Muzeu “Ivezaj”, kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” e nderoi me titullin “**Mirënjohja Martin Camaj**”, me motivacion: “*Për vlera të spikatura e të veçanta në gjurmimin dhe koleksionimin e vlerave të kulturës kombëtare popullore në fushën e etnografisë; për vetëdije, përkushtim e frymëzim shembullor për sot dhe brezat e ardhshëm*”, të cilin e dorëzoi N/kryetari i Shoqatës Atdhetare

“Dukagjini”, zoti Gjergj Leqeja.

Me këtë rast, me porosi të Kryetarit të Shoqatës së vëllazërisë Kosove – Malësi e Madhe, Ukshin Jashari,

Shtjefen Ivezaj, zotit Vuksan Sokoli, ju dorëzua një mirënjohje e dhënë nga kjo shoqate, për Zef Lulash Sokolin, babën e tij, për pjesëmarrjen e kontributin e tij në gjithë veprimtaritë e zhvilluar në Kosove, me kuadrin e manifestimeve “Zëri i vëllazërisë”.

ti vijnë në ndihme kësaj familje, e cila po jep maksimumin nga ana e vet, por që nuk mjafton pasi një pjesë e tyre rrezikojnë të prishen, të dëmtohen

Mirënjohje, respekt dhe vlerësim të pafund për punën dhe pasionin deri në vetëmohim të zotit Shtjefen e zonjën Gjyste Ivezaj...

Falënderojmë ata që mundësuan



Ngaqë ja dimë rendësin e shohim, si nevojë për ta ndjekur dhe pare gjendjen aktuale të këtij fondi të arte, i cili ruhet në kushte jo të përshtatshme dhe që rrezikohen të dëmtohen. Gjejmë rastin të bëjmë apel dhe thirrje për strukturat kompetente ti japin rendësin e duhur këtyre vlerave të kulturës sonë kombëtare,

përfaqësuesit e shoqatës Atdhetare “Dukagjini” të marrin pjesë në këtë 15 vjetor të Muzeut “Shtjefen e Gjyste Ivezaj”, zotërinjtë Gjergj Leqeja, Mhill Prroni dhe Anton Kosteri, me shprehjen popullore: “Paçin e dhëncin!”

Pergatiti Lulash Brigja

Përkujtohet revolta e Spaçit

Me 21 Maj 2017, ditën e diele, u organizua në Spaç të Mirditës ceremonia përkujtimore e Revoltës Antikomuniste të vitit 1973, e cila shpërtheu mes të dënuarve në Burgun e Spaçit.

Është i pesti vit radhazi që kjo veprimtari organizohet nga Komisioni Drejtësi dhe Paqe i Shqipërisë, ent i Kishës katolike, me të cilin Shoqata Atdhetare "Dukagjini" ka traditë të hershme bashkëpunimi.

E zhvilluar gjatë paradites në mjediset ku dikur ndodhej burgu famëkeq i Spaçit, në ceremoni morën pjesë rreth 200 persona. Pati përfaqësues nga shumë organizata të ish të përndjekurve politikë,

përfaqësues të autoriteteve vendore, personalitete të shquara të politikës, artit, kulturës dhe medias.

Në qendër të vëmendjes ishte heroizmi dhe sakrificat e të dënuarve të burgut të Spaçit, të cilët në kushtet e një represioni të egër, gjetën forcë në vete të ndërmerinin një akt qëndrese. Ajo që nisi si një shpërthim i zemërimit të dy të dënuarve ndaj keqtrajtimit nga rojat dhe punës sfilite në minierën e bakrit, u përhap si flaka në bar të thatë dhe përfshiu gjithë të burgosurit.

Të organizuar, ata qenë në gjendje të mposhtnin rojat dhe për tre ditë u bënë zotë të vetëm të kampit.

Nga tarrace e njëres prej fjetoreve, ata lëshonin thirrje kundër regjimit dhe shprehnin dëshirat për një Shqipëri, ku të mbretëronte pluralizmi politik dhe demokracia sipas modelit të vendeve të Evropës Perëndimore.

Momenti kulmor i revoltës ishte ngritja e Flamurit Kombëtar, pa yll, mbi tarracë. Flamuri u improvizua me një cohë të kuqe, mbi të cilën piktori Mersin Vlasi vizatoi shkabën e zezë dykrenore. Për tre ditët e kohëzgjatjes së revoltës, pranë Flamurit bënë roje Ndrecë Çoku dhe Shuaip Saiti.

Autoritetet e shtypën me egërsi revoltën duke përdorur reparte të trupave special të Forcave të Armatosura. Katër protagonistët u dënuan me vdekje dhe u ekzekutuan. Këta martirë ishin: Hajro Pashaj, Dervish Bejko, Skënder Daja dhe Pal Zefi.

Me 21 Maj 2017, në përvjetorin e 44 të revoltës, në një analogji shumë të goditur, përsëri moment kulmor i ceremonisë ishte ngritja e Flamurit nën tingujt e Himnit Kombëtar. Në mënyrë simbolike, Flamuri u ngrit nga një pjesëmarrës i mbijetuar i revoltës, ndërkohë që katër nxënës të shkollës së mesme "Atë Pjetër Mëshkalla" mbanin në krahlor nga një fashë me emrat e martirëve të revoltës.

Presidenti i Komisionit Drejtësi dhe Paqe, njëkohësisht edhe Kryetar i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij Imzot Angelo Massafra (OFM), u shpreh në fjalën e tij përshën-

detëse:

"Kur u njoha së pari me historinë e persekutimit komunist të popullit tim, habitesha si kishte mundësi që këta njerëz nuk kishin bërë rezistencë në mbrojtje të vlerave dhe besimit të tyre, si martirët tanë. Revolta e vitit 1973, vërteton qartas të kundërtën..."

"Është e domosdoshme pra, vijon Imzot Massafra, që burgu i Spaçit të merret në mbrojtje nga shteti dhe të shndërron në muze për t'u përcjellë historinë brezave të rinj në mënyrë që gabimet e saj të mos përsëriten. Po ashtu, që viktimat të kujtohen me nderimin dhe respektin që u takon, është e nevojshme që 21 Maji të shpallet si Dita Kombëtare e Kujtesës për viktimat e persekutimit Komunist në Shqipëri..."

Duhet thënë se përmasat e ceremonisë përkujtimore kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit që prej herës së parë në vitin 2012. Shoqata Atdhetare Dukagjini ka dhënë vazhdimisht kontributin e saj duke ndihmuar Komisionin Drejtësi dhe Paqe në mbarëvajtjen e veprimtarisë.

Në ceremoninë e parë në vitin 2012, Kryetari i Shoqatës Atdhetare, zotëri Ndue Sanaj, ishte ndër ata që folën për të pranishmit. Në 21 Majin e 2017, një prej kontributëve të SHAD, është edhe dokumentimi me fotografi i çasteve më të spikatura të organizimit. Disa prej tyre i kemi përzgjedhur dhe kemi kënaqësinë t'i ndajmë me ju.


Nga **VLADIMIR BANUSHI**



Malësia e Madhe në antikitet përfaqsohet nga stacionet Cinna dhe Berzumno

Duke ju referuar fakteve historike si dhe gjetjeve arkeologjike të deritanishme është bërë e mundur të përcaktohet qartazi se ku shtrihen trojet etnike shqiptare me prejardhje ilire, pjesë e së cilës është edhe Malësia e Madhe. Me përcaktimin e kufijve politik të vitit 1913 hapësira territoriale e Malësisë së Madhe u nda në dy nënshtetësi, ku njëra pjesë gjendet në skajin veriperëndimorë të Republikës së Shqipërisë dhe pjesa tjetër shtrihet në skajin Jug-Lindor nën Malin e Zi. Kjo ndarje brutale territoriale përveç pasojave sociale-ekonomike ka pasur edhe shumë anë të tjera negative siç janë politiko-kulturore, mbi të cilat kanë ndikuar drejtpërsëdrejti politikat e qeverive përkatëse, gjithashtu negativisht kane ndikuar edhe mbi studimet e mirëfillta shkencore, ku përcaktohen vlerat social kulturore të krejt Malësisë së Madhe duke bërë që ato të kenë mangësi, njëanshmëri, si dhe të jenë të pa plota, për aq kohë sa nuk janë gjithëpërfshirëse në përcaktimet e veta. Studimet më të shumta mbi këtë territor dhe banorët e saj, na vijnë që nga periudha e mesjetës e në vazhdim, gjë që lidhet me shumëllojshmërinë e burimeve të shkruara si dhe me vete faktin se ngjarjet historike janë më të fresketa. Sa i takon periudhës tjetër e sidomos asaj antike, burimet shkencore varen kryesisht nga studimet arkeologjike si dhe shkrimet e autoreve antik, gjë që specifikisht për Malësinë e Madhe janë krejt të vakëta. Ky fakt ka bërë që ky territor të studiohet duke e përgjithësuar në rang rajonal ose duke përdorë metodën shkencore të krahasimit, ndaj dhe studiuesit janë detyruar të ndërmarrin vetë ekspedita studimore në terren, ku fale këtyre studimeve na përftohet një përshkrim historik (për fat të keq empirik) për sa i takon periudhës antike e deri në mesjete. Ajo që ne njohim pak më shumë është territori i Malësisë brenda kufijve politik të Shqipërisë, ku një ndihmese të madhe në këto studime kanë dhënë arkeologët dhe studiuesit e disiplinave të ndryshme që lidhen drejt për drejt me shkencën e historisë, pasi, ashtu si kudo në trojet shqiptare edhe në Malësi të Madhe gjurmët e antikitetit janë prezent kudo në këtë hapësirë territoriale, kryesisht në ultësirën perëndimore të saj, si kështjella në Hanin e Hotit, Kisha e Brigjes së Hotit, Kallarja dhe Gomilate Moksetit në Kastrat, Bazilikat e Lohes në Shkrel, Varrezat e Kalldrunit në Koplik, Kisha e Vjetër e Pjetrosanit, Kisha e Vjetër e Grykës së Therqit në katundin e Kastratit, Kisha e Vjetër në Gruemirë, e shumë e shumë varreza e objekte të tjera, të cilat gjinden kudo në Malësi, çka dëshmojnë se ky territor ka qenë mjaft i populluar që në lashtësi. Objekti më i vjetër dhe më i rëndësishmi sa i takon gjurmëve më të hershme antike në këtë territor brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë është cilësuar nga studiuesit Kështjella e Marshëjit ose siç quhet ndryshe Qyteza antike e Marshëjit. Pas një studimi të hol-

lësishëm të një grupi arkeologesh të udhëhequr nga arkeologu më i shquar i kohës, Hasan Ceka rreth viteve 70, kanë dalë në përfundimin se, kështjella e Marshenjit është i vetmi fortifikim ku na shfaqen të dalluar qartë dy teknika prehistorike, ajo me ledhe guri dhe ajo me mure guri, në të cilën ruhet pothuajse i plote fortifikimi i tipit të pare. Për kështjellën e Marshenjit kanë shfaqë interes edhe studiuesit austriak Prashinger e Schober, të cilët e kane vizituar këtë objekt, madje duke ju referuar edhe hipotezës së tyre në përshkrimin përmbledhës studiuesit kanë dale në përfundimin se, kështjella e Marshëjit ndodhet mbi një kodër shkëmbore me faqe mjaft të pjerrëta pranë fshatit Marshëj. Nga veriu, kodra lidhet nëpërmjet një qafe të lartë me vargun e kodrave fqinje. Mbi majën e saj ndodhet një shesh i vogël me përmasa 50 x 60 m, ku nuk mungojnë grumbuj shkëmbinjsh të veçuar që ngrihen deri në lartësinë e shtatit të njeriut. Kjo sipërfaqe rrethohet nga një ledh sipas një planimetrie eliptike. Studiuesit pohojnë se, muri rrethues nuk është ndërtuar mbi konturet e platformës së kodrës, por disa metra më poshtë, çka shihet edhe me sy të lire, në shpatet e pjerrëta të saj. Siç shihet edhe në të dy fotot, ledhi ndjek një linjë të valëzuar, që vijon gjatë gjithë gjatësisë dhe është ndërtuar me gurë të vegjël dhe mesatarë të hedhur pa rregull njëri mbi tjetrin. Ata, gjate studimit vunë re se, vende - vende midis shkëmbinjve janë hedhur gurë për të plotësuar boshllëqet, ndërsa hyrja formohet nga faqja e një shkëmbi dhe skaji i ledhit, kurse qafa, që lidh këtë kodër me kodrat fqinje, mbyllet në anën e kalueshme më lehtë nga një mur i drejtë me



Kështjella e Marshëjit, në Malësi të Madhe.

gjatësi 90 m, i cili është ndërtuar me një teknikë më të përparuar. Ai ka një gjerësi prej 2, 70 m, dhe përbëhet nga dy faqe të ndërtuara me gurë të papunuar, pa ndonjë mjet lidhës dhe që në brendësi të mbushur me gurë më të vegjël. Ky mur i përket një periudhe të dytë ndërtimi. Megjithëse nuk janë kryer ende gërmime të mirëfillta arkeologjike në këtë vendbanim, arkeologët thonë se teknika



Varrezat tumurale ose kodër varret e Marshëjit

dhe ekzistenca e dy tipave të ndërtimit çon në përfundimin se fortifikimi me ledhe duhet t'i përkasë periudhës së bronzit, kurse ajo me mure guri duhet ti përkasë fillimit të periudhës së hekurit. Edhe për varrezat tumurale që janë rreze kështjellës, arkeologët janë të mendimit se i përkasin banorëve të kësaj qyteze antike pasi ndodhen shumë pranë saj. Prezenca e tumave kudo në Malësi dëshmon se ky territor ka qenë mjaft i populluar që në lashtësi, ku ruhen ende në gojëdhënat e të pareve se territori përreth kështjellës ka qenë shume i populluar sa shëtiste macja tra me tra. Gjithashtu tregohet për një zjarr, i cili shkrumboi krejt këtë qytetërim duke mos mbetur asgjë pa u djegë e plaçkitë nga pushtuesit e huaj, çka i detyroi banorët të tërhiqen e të dalin në male për të mbijetuar kësaj katastrofe, ku ndoshta kjo ka qenë edhe arsyeja pse fondet burimore janë krejt të pakta për ta dëshmuar këtë qytetërim, pasi edhe ato që mund të ekzistojnë gjin-




Fig. 1 Provinca e Prevalis

den thelle nën toke të mbuluara nga erozioni që ka vepruar për mijëra vite mbi to. Sa i takon Malësi të Madhe, që është për të ardhur keq se, edhe ato pak fonde të gjetura rastësisht apo dhe gjate hulumtimeve të ndryshme nga studiuesit vendas dhe të huaj, gjinden të ekspozuara në dy muzetë, në atë të Tiranës si dhe në atë të Shkodrës, çka dëshmon qartë për mos interesin i pushtetit vendor si dhe banor-

eve të Malësisë së Madhe, për të ndërtuar një objekt, ku të ekspozohen vlerat kulturore dhe të vërtetat historike të saj. Bazuar në burimet e shkruara na del se, situata pas rënies së Mbretërisë Ilire, nën sundimin romak si dhe reformës territoriale që ndërmori Perandoria Romake, territori i Malësi të Madhe u përfshi në Provincën e Prevalit, ku duke ju referuar hartës së kësaj province, vërejmë dy stacione antike përgjatë rrugës që zgjaton nga Shkodra për në Diokle. Në përshkrimin dhe studimin përmbledhës sa i takon ketyre stacioneve të bërë nga Jovan Adami, i cili bazohet kryesisht në të dhënat e tabulës Peuntingeriana, itinerarit Antonin, dhe atij të Ptolemeut (II,16), që nga Naronë në Dalmaci nisej një rrugë, e cila, duke kaluar nëpër Malin e Zi zbrishte nga fusha e Koplikut për në Shkodër. Ai pohon se, si stacion i parë i kësaj rrugë, në tokën Shqiptare shënohej Cinna, ku sipas tabulës Peuntingerjane ky stacion ishte 20 milje, gati 28 km në veri të Shkodrës. Gjithashtu ai, thekson se për vendndodhjen e këtij stacioni ka pasur hipoteza të ndryshme nga studiuesit, psh sipas Kipertit mendohet se stacioni Cinna ishte në afërsi të Koplikut të sotëm; ndërsa Ipeni ishte i mendimit se rruga duhet të këtë kaluar rrezë kodrave e larg buzës së liqenit. Një tjetër mendim ka pasur Paçi, i cili e vendos stacionin Cinna buze Rrjollit. Si hipoteza më e saktë mendohet ajo e Prashniker dhe Shoberit, të cilët janë të mendimit se ai stacion ka qenë kështjella e Marshenjit, pasi ajo me pozitën e saj sundonte Fushën e Përroit të Thatë dhe kontrollonte njëkohësisht edhe një rrugë, e cila zbrishte që nga malësitë për në Koplik dhe nën Marshëj takoheshin me rrugën kryesore. Stacioni tjetër, i cili po ashtu gjendet në territorin e malësisë quhej Berzumno, ku sipas të dhënave del se edhe ai gjendet brenda territorit të malësisë dhe konkretisht në veri të Hanit të Hotit, brenda territorit të Shqipërisë, nga këtu rruga zbrishte në fushën e Podgoricës. Po të merret para-

sysh formacioni i terrenit, si dhe ana tjetër studimore e malësisë nën Malin e Zi, të bëra nga Prashniker dhe Shober stacioni Berzumno nuk mund të identifikohet me Brigjen në Mal të Zi siç e bën Mileri në veprën e tij thotë J. Adami, pasi rruga antike nuk kishte arsye pse të ngjitej në malësi ku ishte Brigja dhe pastaj nëpër një mal përsëri malor të zbrishte në fushën e Podgoricës. Ai shton se Mileri që ka shënuar rrugën antike në

PARAQITJA E DY LIBRAVE, ME AUTOR PREG CUB LLESHI

Me datën 18 mars 2017, në Tiranë, një rrugë dhe dy punë!

E para, në mjediset e hotel “Drini”, u zhvillua një ceremoni e paraqitjes së dy librave të publicistit, poetit e historianit Mirditor, Preng Cub Lleshit . Kjo ceremoni ishte e organizuar nga Shoqata e Bashkuar “Mirdita”. Ishim të ftuar nga Kryetari i kësaj Shoqatë, zoti Gjon Lleshi,

kolonel në pension.

Në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, morëm pjesë në këtë paraqitje, Ndue Sanaj e Lulash Brigja. Një ambjent tipik artistësh që të imponohen më çdo detaj. Sa për librat ende pa i lexuar mund të them se duken interesant, ngacmuese.

Në orën 11. 00 filloi veprimtaria nga shoqata e Bashkuar “Mirëdita”. Fjalën

për librin e pare e mbajti akademiku Mark Trita, ndersa për librin e dyte e mbajti Nikoll Gjini. Në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, përshendeti Kryetari i Saj, Ndue Sanaj.

Por jo vetëm kaq. Bëme takimet e fundit organizative për një veprimtari madhështor, që javën tjetër do zhvillohej në Presidencë. Kështu takuam Lazer Stanin,

më vonë me Kolonel Petrit Çunin, me Zef Barin dhe me Gjovalin Prronin, me të cilet biseduam për pjesëmarrjen në ceremoninë që do të zhvillohej në Presidencë, për dekorimin e Dukagjinit.

Korespondenti i “Dukagjini”




këto anë nuk e ka studiuar gjendjen e terrenit në vend, por ka marrë si bazë ngjashmërinë e emrave dhe largësitë e dhëna nga tabula Peuntingeriana dhe itineraret. Nisur nga ky fakt vlen të qartësojmë dyshimet duke u bazuar në disa të dhëna burimore të tjera, ku po ti referohemi hartës së vjetër të Coronelli-t që mendohet si më e vjetra dhe më e detajuar sa i takon periudhës antike të trevës së veriut lidhur me aspektet e gjeografisë natyrore dhe njerëzore të kësaj zone na del se edhe gojëdhënat marrin kuptim mbi këtë ndarje të liqenit të Shkodrës, ku

dhe sot ajo vije uji që bashkon këto dy liqene quhet Vija e Batakut dhe veç kësaj ka zëra që vijnë edhe nga peshkatarët, të cilët ankohen për disa shtylla druri të ngulura në toke po në këtë hapësirë territoriale ku shihet i ndare liqeni (sidomos nga Flaka në Kalldrun) çka hell dyshime se, në këtë territor ka pasur edhe vendbanime të tipit palafit përgjatë bregut të liqenit. Referuar këtyre fakteve del se Mileri jo më kot e ka bërë këtë përcaktim, veç kësaj të dhëna shumë të rëndësishme na vijnë nga dokumentet e vjetra të kishës sa i takon kësaj harte. Nëpër shkri-

met e veta Shën Pali, gjatë udhëtimit të dytë thotë se, kur po ktheja nga Roma për në Azinë e Vogël kalova nëpër Iliri, e kështu tuj ja nisë prej Berejet (gjytet i Maqedonis) bana rrugë tuj predikua, ku kalova neper vendet e Korçës e të Elbasanit, e tu ju ngjite nalt erdha e hina në Durcë, prej Durcit msyna fushën e Zadrimës e gjithë here tuj mjellë e tuj derdhe farën e Unjillit, ku tuj ece ju afrova Shkoderc, e mrapa tuj ece kah bregu i liqenit nën Kastrat kalova nëpër vendet e Dioklese (Potgorica e sotme). Ky dokument fakton se liqeni i Hotit ka qenë i ndarë dhe se Kastrati ka përfshi krejt hapësirën territoriale përreth kështjellës së Marshëjit, duke llogaritur faktin se udhëtimi i Shën Palit i përket viteve 10 pas / Kr. Kjo harte dhe këto fakte hedhin dritë edhe mbi hipotezat sa i takon stacionit Berzumno si dhe mendimit të Milerit lidhur me identifikimin e tij në Brigje pasi vendi ka qenë i mbuluar me uje. Një tjetër e dhënë shumë e rëndësishme është ajo e Atë Shtjefen Gjeçovit tek Kanuni i Leke Dukagjinit lidhur me Brigjen, i cili e përcakton si vendi ku mblidheshin krerët e maleve në kuvend, në oborrin e Kishës së vjetër të Brigjes. Këto stacione të njohura shume pak, e shume me pak të përmendura, janë të dhëna kyç për historinë antike të Malë-

sisë së Madhe. Të gjitha këto fakte na çojnë në mendimin se Malësia e Madhe ka një histori mjaftë të mistershme dhe njëkohësisht të rëndësishme, e cila çuditërisht vijon të mbetet në pluhurin e harresës dhe pavëmendjen e duhur shkencore, ndoshta kjo për faktin e vetëm, ku siç thekson edhe Gjeto Duka, në fjalimin e vet në një Konferencë shkencor mbi Kelmendin “Kelmendasit patën shpate e pushke, patën edhe urti, organizim e veprim të përbashkët, me të cilat bënë emër në histori, por nuk patën pene për ta shkruar historinë e tyre”, pohim i cili fare mire mund të thuhet për krejt Malësinë e Madhe dhe që mbetet në kunturet e një thirrjeje për sensibilizim e intelektualëve, bijve të malësisë për të nxjerrë në dritë rrënjët e vërteta të historisë të tyre dhe të ngrënë zërin për bashkëpunim me institucionet qeveritare, të cilat duhet ti japin me tepër vëmendje vlerave social-kulturore të Bashkisë së Malësisë së Madhe si dhe mbrojtjes së tyre në bashkëpunim me pjesën tjetër të malësisë nën Malin e Zi. Kjo është një detyrë emergjente për faktin se prurjet e shumta amatore, të cilat po merren si të mirëqena nga institucione dhe individ jo kompetent, po e dëmtojnë edhe më shumë historinë e vërteta të malësisë.

Rita Shkurtaaj, historiane



Harta e Coronelli-t

Impresione nga libri “Konstelacioni Françeskane” i autorit Angjelin Deda

Nuk dihet saktësisht data e ardhjes për here të pare e françeskaneve në Shqipëri. Mendohet se Shën Francesku i Asizit, i cili është edhe themeluesi i këtij urdhri, duke u kthyer nga Egjipti, në vitin 1220 ndaloj në Lezhe dhe themeloi vëllazërinë françeskane.

Mendohet, që françeskanet së bashku me Dominikanet në Shqipëri i ka sjelle Gjon Pian del Karpino (1182 – 1250), i cili në vitin 1240 emërohet arqipeshkev i Tivarit, me pikësynim, me përmirësuar gjendjen e mjerueshme të popullit, me vendose funksionin në mes lpushkvisë së Dobrovnikut, ku shumica ishin dominikan shqiptar nga Durrësi dhe arqipeshkvisë së Tivarit.

Në vitin 1240 Dera e Madhe e Dukagjinëve, kësaj vëllazërie i jep strehe në Lezhë, në kodër Marlekaj. Por lajmi i pare i sigurtë, që dëshmon për praninë e françeskaneve në Shqipëri është letra e Papës Aleksandër IV, e datës 13 shkurt 1258, me të cilin ai urdhëron arqipeshkvinjt e Zarës dhe të Tivarit, që të marrin në mbrojtje fretërit minor (OFM), ti mbroje nga sulmet dhe nga pengesat e ndryshme.

Kuvendet françeskane shqiptare deri në shekullin XV përfshihen në kustadine e Dubrovnikut te provincës Dalmatin. Papa Bonifaci, me vendimet e tij të datës 13 dhjetor 1402, dy vjet para se të vdiste (1398 – 1404), Kuvendet Shqiptare i ndau nga Dubrovniku dhe i kaloi në administrimin të kustadins së Durrësit, në të cilën përfshihej e Durrësit, Shkodrës, Tivarit dhe të Ulqinit. Arsyeja e këtij organizimi ishte invadimi i Turqve në këto vise.

Në vitin 1464 Kustadia shqiptare quhet kustadia e Kotorrit e provincës së Dalmacisë, në të cilën përveç Kuvendit të Durrësit kishte edhe ato të Lezhës, Tivarit dhe të Ulqinit.

Në vitin 1488 Papa Inoçenti VIII françeskaneve shqiptare i dorëzon Kuvendin e Shën Marisë, në Kepin e Rodonit. Me datën 3 mars 1592, Klementi VIII (1592 – 1605) miraton vendimet e eproreve të urdhrit Françeskan, që Kustadia shqiptare të shpallet “Province” me të gjitha të drejtat e provincave të tjera. Me këtë rast edhe të shpallet edhe pse në kushte më të vështira të pushtimit të egër turk, u themeluan edhe 4 kuvende të reja Vela, Oroshi, Qafe Kraba dhe ai i Kurbinit.



Historia dymijë vjeçare e popujve të Evropës është karakterizuar nga lufta e ashpër në mes frymës religjioze të mentalitetit aziatik despotik islam, që ishte një sistem teknokratik, normat religjioze të të cilit transmetoheshin në norma juridike shtetërore, dhe normat religjioze



të krishterimit Evropian Perëndimor.

Në këtë luftë shumë shekujshme françeskanet shqiptar ne na bëjnë të ndihemi krenare në të gjithë aspektet e jetës tone. Çështja e identitetit shqiptar për ata, mbeti përherë primare dhe i patjetërsueshme. Rezistenca e skajshme ishte tipari dallues i tyre. Ky tipar mani-

festohej si tension shpirtëror dhe fizik në binomin “FE e ATDHE”. Binom, në të cilin vlerat e fesë përkonin saktësisht me ato të kombit. Dhe prandaj duhet të përulemi para veprës së tyre. Dhe para shume klerikëve të tjerë, të cilët lakonin fenë njëloj me çlirimin kombëtar dhe shërbimin fetar, me të drejtën për të qenë i lirë. Dhe ja dolën të mbijetonin edhe kur virusi komunist helmoi një pjesë të trupit të kombit, shpirti i të cilit u dënua të shuhej, dhe Shqipëria u izolua. Konstelacioni françeskan e kishte rrallën i pari.

Ishin vetëm 160 klerikë, që kishin kryer 450 vjet studime në 24 universitet më të njohura të Evropës deri në vitin 1944, kur për fatin e keq të tyre dhe të popullit që i lindi, filloj spastrimi i tyre.

Por sikur të mos mjaftonte kjo, në vitin 1967 do të niste faza e dyte. Ajo më tragjikja! Gjate kësaj faze ato do të bënin 881 vite burg, që do të thotë 9 shekuj burg në token e tyre. Vetëm ata që u pushkatuan bënë 250 muaj tortura në hetuesi, që do të thotë 21 vite.

Ata që vdiqën gjate torturave qene më me fat, sepse bënë vetëm 68 muaj hetuesi.

Në harkun kohor 1944 – 1990:

*Nga 156 priftëri, nga 6 ipeshkvi shqiptare, të cilëve u duhen shtuar edhe ato që u shuguruan më vonë:

3 prej tyre u zhduken në mënyrë misterioze nga sigurimi famëkeq i shtetit, brenda dhe jashtë shtetit, si: Matish Sheldia (1924 – 1974), u helmua; Prek Nikçi (1921 – 1974); Lazer Sheldia (1928 -), vrarë në SHBA.

Këta bij dhe bija shqiptare apo të huaj dashamires të kësaj toke martire përpara se të ishin klerikë, qene atdhetare, tribune të mendimit të lirë. Ndaj nuk mund të themi, që u mohua thjesht feja. Por u mohuan përpjekjet për dije, progres dhe civilizim, që përfaqësohej nga këta figura. Prandaj nuk gaboje aspak të deklaroj me zë të lartë, se konstelacioni françeskan ishte ai organizim i gjalle vetëveprues, që ruajti të pacenuar dhe përcolli në breza cilësitë më të vyera të AND – së së kombit shqiptar.

Nëse Shkodra sot është djepi i kulturës, është arsimit, muzika, sporti, teatri, opera, kinemaja, fotografia dhe shumë të tjerave duhet t’ia dimë për nder këtij konstelacioni të shumëvuahtur.

Autori i këtij libri:

Zotëri Angjelin Deda, miku im i vjetër dhe pas sodit pa dyshim edhe miku i të gjithë lexuesve të këtij libri, me shumë vlere, duhet përgëzuar për punën e tij shume serioze.

Autori nëpërmjet një botimi shume luksoz na jep një vepër që mund të konsiderohet si një “Fjalor enciklopedik i kujtesës” për të gjithë figurat e këtij konstelacioni që rrjedha dallgësh të kohës i ka përcjellë padrejtësisht harresës.

Libri vjen disi ndryshe, pa fjalë, nëpërmjet fotografisë dhe rikthen në kujtesën kombëtare personalitete të vyera që kane punuar pa kursyer asgjë për jetën e qytetit tone.

Mesazhet që përcjell libri komunikojnë drejtpërsëdrejti me lexuesit. Janë të dhimbshme, impresionuese falë edhe të veçantave të artit të fotografisë.

Angjelin Deda ndoshta është i pari, që lëvron këtë zhanër, prandaj libri të shkoje shume shpejt atje ku duhet, tek lexuesi për të davarite mjegullën e harresës.

Vepra e zotëri Angjelin Deda është një përmbledhje dokumentesh vizual të historisë së qëndresës së shtresës më të shkolluar të popullit tonë, në tërësinë e përpjekjeve kundër dëshirës së çmendur të atyre që donin që Shqipëria të behej i pari shtet ateist në botë.

Nga Dr. Luigi Martini

Pak Histori ...



Nosh Vuksani
nga Itali

PREKALI

Jam me orgjinë e gjak nga Shoshi, një vend i vogël, por kompakt dhe me një histori të madhe ku ruajt traditat më të mira të popullit, rekord me të gjitha fshatrat e tjera....

1. I bani balle ne 5 shekuj pushtimit Osman dhe nuk pranoj të ndërronte as fenë dhe asnjë ëmën

2. U mësy disa here nga forcat Turke, nga forcat Sllave, dhe Prekali ju bani bal- le në sajë të pozicionit strategjik dhe të marrëveshjeve të lidhura me fqinjët e tij, me Postriben e Dukagjinin.

3. Prekali në kohën e Austrisë kishte postëkomandë, kishte Han, dyqan, bar - pijetore, kovaçhane, rrobaqepësi për prodhimin e shajakut ku priteshin e qepeshin rrobat tradicionale. Ajo që asht marre me ato pune ka kene Shkurte Tom- ja, bije Tthethit, e martume në Prekal. Ajo bashke me 1 a 2 shoqe të sajat, kjo ishte kryesore për ket pune, ishte mbes Vuthajsh. Thonë se ishte shume e bukur e punëtore. Këtu porositeshin veshje tradicionale për mbare Dukagjinin e ma tej. Kishte opingarë ku qepeshin opinga lëkure me porosi. Kishte artizanat për bishta fshesash, pjese për qerre e për karroca, që përcilleshin në Shkodër, që kishte lidhje tregtare. Në vitin 1951 asht hap kooperative Artizanatit në Prekal dhe asht drejtue nga Zef Deda, kryetar e llog- aritare Ndue Çun Sokoli, me teknik cilësie Palok Gjoni. Ajo lidhej me kooperativën Metalike të Shkodrës. Punonjësit ishin të pajisun me librezë pune. Prodhimi në atë kohe përcillej me kafshe. Shkolla e pare në krejt trevën e Malësisë së Veriut, asht hapun afro 100 vjet më pare.

Në Prekali, në kohën e Mretit Zog ka pase Komune me krytare Komunet Sali Babameto e me Sekretar Shaban Der- vishi. Ka pas xhandarmeri të vendosun me qera, në shpin e Mirash Noshit, afër Kishës. Ka pas gjendje Civile dhe Central Telefonik. Edhe në kohën e Italisë ka pas post komande me 10 xhandar shqiptare të shoquem nga dy Italian Mاتيaci dhe Pareta. Prekali karshi atdhedashurisë diti të ruaj kulturen qytetare, qetsinë në mes vehtes dhe të fqinjeve, dhe ka afer- sisht mbi 60 vjet pa u vra në mes vedit. Nji vrasje, nga nji minoren ka qene aksi-

dentale e pa qëllimshme në familje dhe ka mbi 160 vjet pa u vra me fqinjin e tij, Postriben të besimit Mysliman. Prekali mbylli kishën dhe çoj meshën e fundit në të gjith Shqipninë, me datë 28 Mars 1967, nga Monsinjon Antonin Fishta dhe organizata baze e partisë punës në Prekal nuk e lejoj ta burgosin, por vdiq vete në shpin e tij. Asnji organizate shoqnore në demokraci nuk i ka ra ndërmend për ket klerik ta shpalle qytetar nderit për Du- kagjinin, vetëm ju bien ndërmend për të gjith diktatorët komunist si i mbyllen ob- jektet e kultit ktyne, ju jep vlere Dukagjini dhe kto figura si At’ Shtjefen Gjeçovi, që hapi shkollën e pare shqipe apo At’ Anto- nin Fishta si e mbylli i fundit, për intele- ktualët e Dukagjinit BTA mbesin në hije.

Prekali, në vitin 1951 kishte sekre- tar lokalitetit prekalor në Mes dhe polic lokalitetit. Në ket vit hodhën 51 vota kundër komunizmit, kthyen poshtë të deleguemin e partisë punës dhe nuk lejuan të merrej në burg asnji njeri Pos- riba, e mbajti Prekalin nen sqtull si nji djalë dishirit për 45 vjet me rralle. Gjith- monë i ka pas në detyrë njerëzit e vet, si në komunizem dhe në demokraci. Në kohën e komunizmit për të festue Prekali festat i jepeshin leket paradhanje në Pos- tribe. Pra, festonte festat fetare katolike, mbante derra lirshëm duke qene e gjith Postriba muslimane.

Ky trajtim i jashtëzakonshëm, me i leju festat fetare, me ndalu i fundit kishen, më tregoni kush ta kishte leju në Dukagjin në atë kohe, zoterij intelektual?!

SHKODRA

Si mbas regesit Imzot Palë Kamësit, në vitin 1745 Shkodra kishte kto lagje:

“... Tophana ku ishte qendra famulli- tare e kishës katolike të Shkodrës, me të krishterë të fshehte, 150 shtëpi me 680 fryme, por të krishterët aso kohe quheshin laramane, se emrat, shumica i kishin Muhamedane, por në fakt ruheshin parimet plotësisht të krishtera e shumica bënin ritet e fesë tinëz Turqve dhe kjo lagje kishte laramane dhe 33 frymë. Ki- sha e Tophanës ju kishte kushtua Shën Dodës. Kazena, me 140 shtëpi, me 459 frymë. Kjo përfshinte Shën Lavrentin, me dy shtëpi, me 10 frymë.

Kishaj, me 9 shtëpi me 25 frymë kjo lagje, e cila shtrihet matanë urës së vjetër të Bunës, krahu i majtë i rrugës së Shi- rokës, kishte 2 kisha, njëra Kisha e Shën Mandalenes, ku asht sot dhe tjetra kisha e Shna Prendes.

Varret ishin në Zarufe afër Shirokës, ku tani janë varrezat e fshatit Shirokë, i cili kishte 63 shtëpi, me 384 frymë dhe përfshinte lagjen Kepi i madh, nji ore larg Shirokës, kah Zogajt, me 11 shtëpi dhe 49 frymë.

Dokumentet vetëtojnë se varre të ipeshkvijes kishte dhe në kisha te Shna Prendes ...

Regesti i Venedikut shkruen, se kur në v. 1610, Meshari kërkonte me dhanë meshe në Rrmaj, ku asht katedralja, Ki- sha Madhe, sot përshkohej nëpër fu- sha pjellore të Gjuhadolit, Sarreq, SOT

PO THUAJ ZEMRA E QYTETIT të Shkodrës.

Simon Gjini, i cili ka vdek në moshe të shtyme afro 90 vjetëve, tregonte se Rrmajt ishin pas shtëpisë së Mark Naraçit, te varret Katolike sot, para 131 vjetëve në këtë vend nuk pati kisha, vetëm se një kisha mbi shtylla me hajat mbështetës, se aty kuptohet (shënimi i im), se në per- iferi kishte ushtri Turke, vetëm te ky vend i vogël shuguronte meshtari meshe dhe kure mblidheshin burrnimi me pa meshe xhakoni në vend të kabanës tunde nji shishe me guraleca, në vend të kumones ose ziles. Aty janë kenë krezmimet, ku ndërsa të tjerë, asht krezmue Leci i Kol NDREKES, KRUSHKU I KEL MUZHANIT. Kur burrat delshin nga kisha, e cila zg- jaste 25 minuta më kambe deri te Ura Dervish Beg, ku asht sot, kishin konakët e shtëpisë tyne katoliket. Gratë e tyne zienin oriz për pilaf për familjet e tyne. Nuk asht për tu çudit, sepse 140 deri 160 vjet ma pare te shpija e Loro Pistullit, te Dugajt e Reja, Hila i Hys Metës, rrugëtari i tije, gjyshi i Ndrek Shllakut, ka gjete aty dhe Gjergj Ndok Sheldija, gjyshi i Gjushit, ka gjuajt rosa, ku sot asht sahati i INGL- IZIT, në afërsi te “dollarit”. Se, në oborr të Kishës së Madhe, thonjte plaku i Bosit, i cili ka vdek 120 vjeç. thonjte se aty kam mbjelle sa vjet bostan, dhe ky ka vdek në vitin 1930. Zyra e famullitarit të kishës katolike, sipas shkrimeve të konsullit Francez, Pouqueville dhe të regjistrave të pagzumve të kishës famullitare të qytetit u bart nga viti 1800 e zuni vend në shtëpin e Gasper Muzhanit, në shtëpin e ndodhun, në Rugën e Rrakacojve, aty ku përbri saj u ndërtu kinema Mileniumi, si asht sot te rruga Marin Barleti. Në vi- tin 1857, Ferit Mustaf Pasha zbriti nga kështjella e zuni vend te shpija e Devish Begut, ku tani asht lagja “28 Nendori”. Në atë kohë, lagjet që ishin rreth kështjel- lës, Tabakët, Qafa Ajazma dhe rreth ko- drave të Tepes, TEPIJA, Domnoret, Dra- çini, Kercirejt, Serdarejt, Kahra Hasan, Lugu Çezme dhe në këto vite u ndërtun lagje të reja, si Perashi, Parruca, Zdralej, Garuci, Ndocajt, Kirasi, Derguti, Rus Maxhar, Rus Katolik, Gjuhadoli, Sarreqi, Ballabanja, Badra, Rusi i Madh. Ndërsa si lagje më të hershme përmenden përveç Tophanes së Kishëve, Kazenet, Rremajit dhe Ura Dervish Begut si u quajte Sokak Nemce, nga që në atë vend pat qene konsullata Austriake, Arra e Madhe, Per- ashë Ndocajt, pike referimi një fojleta e puntorve përball lagjes “Skanderbeg”. Aty mblidheshin punëtorët, për pune. Në Rus i Madh, xhamia plake, Hani Salo Kalit, Vorri i Fratit dhe ura e Maxharit, në Rus afër Dobraçit, Pusi i Mar Jubanës në Badra afër TRUMES së DUGAJVE të REJA, E CILA RA VIKTIME PER MBROJTJE TE NDERIT TE BIJES, SI E THËN MIZORISHT nga TURQIT. Rruga e Palin Canes, se aty banonte ajo, që ishte teknike për lamjen e leshit, i cili dërgohesh për eksport. Ura madhe ose ura Jaçit dhe Lama e Spahin- jve, andej nga Ura sotme e Kirit, Çinari Tophanes, Çinari Hoxhllaut dhe Çinari Zef Zorbes - sipër varreve Katolike, Fusha e Qelës - afër saj ishte Kisha e Fretenve, që asht dhe sot, ndërtua në vitin 1905 dhe Qela e saj, që ma vonë u ba shkollë, por me që Myslimanet fëmijët i çonin në Me-

jtep, kjo mbeti për një fare kohe shkolle për katoliket, por kjo u mbylle dhe ma vonë u sekuestrua nga qeveria dhe ju vendos nji minare dhe që nga vitin 1925 figuron xhami. Kjo pati fatin e shume in- stitucioneve të tjera Katolike, ma vonë u shemb nga regjimi komunist dhe përsëri në vitet e demokracisë u ba Xhamia Mad- he Ebu Beker, ku asht sot në qendër të qytetit.

Në vitin 1923, lagje të qytetit ishin këto, Draçini Lugu, Arra e Madhe, Sar- reqi, Ballabanja, Badra, Gjuhadoli, Rusi Nalte, Skanderbeg, Tophan, Shaban Efen- di Has Hot, Maxhar, Kiras, Dergut, Dudas, Ndocaj, Rus i Vogël, Fusha Druve, 28 Nen- duer, Leksaj, plote 30 lagje. Në vitin 1800 kishte 18 000 banore. Në vitin 1819 ra një sëmundje e keqe, murtaja, në Shkodër, e cila bani shume dem në ushtrinë Osmane sa lumi Drin ktheu shtratin, duke u bere pellgje te mëdha. Në vitin 1869, në vitin 1870 e deri 1874, Konsulli Francez Hec- quard numëronte Shkodrën, me 4500 shtëpi, në mes tyre ishin 3000 shtëpi Myslimane dhe në nji pjese e madhe e tyre ishin laramane, nga frika e Turkut, 1400 shtëpi Katolike dhe 100 shtëpi orto- dokse. Katoliket ishin të shkollluar dhe në atë kohë, me 25 fruer 1854 ImZOT Topich, numëron për 75 vjet 29 fakultete Katolike, të vlefshme dhe kjo fale klerit të mrekullueshëm Katolik, që në fshehtësi luftonte injorancën Turke, ku krahas tyre shkolloheshin dhe shume nga vllëzërit e tyre te konvertuar në fenë islame. Për- ballë kësaj gjendje dhe me nderhymjen e konsullatave, si ajo Austriake, Franceze, Ruse e të tjerë, ku kërkonin Turqisë të drejtën e emancipimit të Krishtenve në Fe në Shkodër mbas rrënimit të kishës se vjetër, kishin kërkua të ndërtonin kishën e re në Shkodër. Me 12 Mars 1855, Ko- gregacioni i Propagandës Fide dha dekre- tin për krijimin e një Seminarit Provincial në Shkodër, i cili u quajt Seminarit Pap- nuer. Duhet shënue, se dhe ma përpara ekzistonte nji seminar i tille dioqezan, si kurse dëshmon K. Poten, në dore shkri- met e tij janë faqe 162, ku nder të tjera shkruen, se si Rektor i këtij seminarit, në vitin 1845, ishte Imzot Pal Dod Masaj, i laureuam dy herësh në kolegen urbane dhe mbas tij, Dom Ejll Radoja. Themelet e Seminarit tij u shtinë me 12 Prill 1856, kur nji pjese fanatikesh, te shtyme nga propaganda Turke, shkuan në vend me rrenue muret dhe për ketë patën ba një demonstratë navale në Gryke të Bunës nga ana e flotës Austriake, nen kryesinë e arqidukes Maksimilan. Me 18 shkurt 1857, Dera e Larte lëshoj Fermanin, me të cilin njofti emancipimin e të krishtenve të Perandorisë.... Kol Mati Tukja tregon, se kur populli bani kërkesën, i thane se dona nji kisha sa një lëkure lopët, dhe për ketë ra dakord Parija, por populli rrjep lopën i bani gosten me mishin e saj. Lëkuren e bani drelle dhe mati rrumullak- sine e kishës me te, por ma vonë, kur fil- luan me ba kundërshtime, Fermani ishte i firmosun nga Sulltani.

Pra shif si kanë rezistue Katoliket në atë kohe.

ADRENALINA E MALËSISË SË MADHE

Malësia e Madhe është një trevë shumë e mirënjohur historikisht për tradita të shquara, ku mund të veçojmë mikpritjen dhe bujarinë, trimërinë dhe patriotizmin, por dhe pasurinë e madhe të kësaj krahine për vlerat e jashtëzakonshme etnografike dhe folklorike. Malësia Madhe ka nxjerrë poetë popullorë dhe profesionistë, muzikantë popullorë dhe profesionist, por edhe këngëtarë popullorë dhe profesionistë dhe kështu, siç e ka krijuar natyra me bukuri të jashtëzakonshme Malësinë e Madhe, ajo ka qenë gjithmonë një fidanishte e pashtershme e talentëve.

Për këtë shkrim unë hyra me shumë dashuri në këtë fidanishte dhe nga filizat e saj përzgjedha një këngëtare të re e të talentuar që quhet Elvira Fjerza.

E përzgjedha këtë, sepse ajo ashtu si shumë vajza e djem të kësaj treve, me zërin e saj ruan dhe përçon jo vetëm traditat e zonës, por edhe ato folklorike kombëtare.

Këngëtarja e re Elvira Fjerza, me zërin e saj të bukur dhe me interpretimin e ëmbël, përcjell emocion dhe kënaqësi të veçantë që buron nga shpirti i saj, duke përjetuar fuqimisht çdo notë dhe varg të këngës që ajo këndon.

Që në hapat e parë të saj ajo u shfaq e veçantë plot talent dhe që me daljen e parë në skenë, në një moshë shumë të re ajo u vlerësua për paraqitjen e saj si një zë premtues dhe me vlera të vërteta artistike, që premtonte se një ditë do të bëhej një këngëtare që do të përfaqësonte me dinjitet krahinen ku kishte lindur.

Këngëtarja Elvira Fjerza e nisi "karrierën" e saj që në bankat e shkollës. Ajo në vitin 2012 në një aktivitet të titulluar "Lojra Popullore", organizuar në kalanë "Rozafa" në Shkodër, vlerësohet me çmimin e tretë me këngën "Kënga ime bashkon trojet".

Natyrë e saj energjike e kurajoze, talenti e pasioni për këngën e muzikën, janë faktorët kryesorë që e bënë të njohur emrin e saj. Siç duket, trashëgimia malësore për të bukurën dhe dashuria

për çdo vlerë të saj, kanë qenë një pasuri e madhe shpirtërore që kanë sjellë dhe kanë ndihmuar në formimin e një këngëtareje si Elvira.

Ajo sot është në proces të një albumi muzikor me këngë nga repertori i saj, ku në bashkëpunim me autorët e teksteve Qazim Çela, Fran Kodra, Lulash Brigja dhe Ramazan Çeka, si dhe bashkëpunimi i suksesshëm me kompozitorin Luan Dagistani, Vani Rushiti, Ervin Gonxhi Roland Çuka dhe Behar Neli, së shpejti do të prezantohet me albumin e saj të parë.

Elvira ka realizuar disa videoklipe të suksesshme dhe vazhdon me intensitet për vazhdimsinë e saj në këtë angazhim, duke qenë gjithmonë kështu e mirëpritur



dhe ku mund të veçojmë disa krijime siç janë këngët: "Djalë fantastik", "Je i mirë, por s'je për mu", "Vitet shkojnë", etj.

Krahas performancave të saj në gëzime familjare, Elvira është aktivizuar edhe në skenë, në evenimente të ndryshme kulturore dhe artistike si në: Nikaj-Mërtur, Trevën e Dukagjinit, Shkodra Fest, Hite Verore, trevesat e rrethinave e të tjera

aktivitete si këto.

Talenti i saj, që tanimë ishte bërë evident, ishte një premisë që ajo të thirrej pa ngurrim në vitin 2015 në skenën e Festivalit Folklorik të Gjirokastrës si këngëtare e Malësisë së Madhe, duke u radhitur përkrah shumë emrave të njohur të folklorit shqiptar, që edhe sot e kësaj dite nuk janë shpërndarë nga skena.

Performanca e saj në një duet me këngëtarin e mirënjohur të kësaj treve Arben Delaj, titulluar "Mora bjeshken" në këtë festival u mirëprit dhe u pëlqye, jo vetëm nga publiku, por edhe nga specialistët e shquar të kësaj fushe, të cilët e inkurajuan për të vazhduar rrugën e saj aq premtuese.



Ajo këndoi atje si pjesë e grupit folklorik që përfaqësonte Shkodrën, përkrah mjeshtërave të shquar të folklorit si: Pretash Nilaj, Fran Kodra e Ndue Shytani.

Padyshim që kjo ngjarje ishte shumë impresionuese për Elviren, por edhe një hap i vendosur për të ardhmen, të cilën ajo do ta ndiqte me shumë dashuri e pasion.

Sot Elvira Fierza ndjehet e lumtur, por dhe e emocionuar kur tregon ngrohtësinë që ajo ka ndjerë nga përkrahja e publikut, një fakt ky që ajo e vlerëson dhe e lidh me kërkesat e shumta në evente të ndryshme.

Kështu ajo filloi rrugën e saj si këngëtare, duke dhënë koncerte të shpeshta në Kosovë, Gjermani, Belgjikë, Itali, etj, tanimë duke u prezantuar me identitetin e saj: Elvira Fjerza.

Me shumë emocion ajo tregon për marrëdhëniet e saj artistike me fansat e saj, të cilët shpesh e ndalojnë, e rrethojnë dhe të gjithë së bashku bëhen personazhe të fotove shumë të bukura. Elvira i don dhe i respekton, sepse siç thotë ajo, ata janë juria më e mirë.

Gjatë bisedës me të, me buzë në gaz, Elvira tregon gjithashtu se ndjehet e mbështetur nga njerëzit e saj, shoqëria, por kryesisht nga bashkëshorti i saj Erioni. Në këtë kontekst ajo nuk harron të falenderojë për ndihmesën dhe përkrahjen e pakursyer që ka pasur nga prof. Prekë Mrishaj dhe drejtuesi artistik i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" Bardhyl Hysa.

Krahas pasionit për këngën, Elvira ka pasion edhe shkollën. Ajo vazhdon studimet në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër.

Ajo është një frekuentuese e rregullt e palestrave të fitnesit, duke qenë kështu kërkuese ndaj vetes, në mënyrë që gjithmonë të paraqitet para publikut e freskët dhe e bukur, si një lule e bjeshkëve të Malësisë.

Elvira edhe sot, ashtu si, që në moshë të vogël ka idhujt e saj që lidhen me këngën dhe me respekt përmend emra shumë të njohur të këngës si: Gjyste Vulaj, Afërdita Demaku dhe Elisabeta Marku.

"Duartrokitjet e publikut, thotë me shumë kënaqësi Elvira, do të më mbajnë mua në rrugën e këngës. Jetës time artistike ato m'i japin gëzim e vlerësim dhe unë mendoj se ata dhe familja ime do të jenë gjithmonë çelësi i suksesit tim".

Nga RAMAZAN ÇEKA

*** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi ***

KRYQI

Merrni vesh të ftuem e të pa ftuem
Kryqi asht shumë i bekuem
Pa te s' maten toka e dete
Meriduane e paralele
Asht një busull e gjithësisë
I tregon udhën gjithë njerzisë
Pse ti fusim vedit zori
A asht kryq dhe somofori
Kryq ban murin muratori
Pamvarsisht se çka thote feja
Kryq asht ba dhe minareja
Kostrukti kryq ka çdo gjallesë
Për pa kryq nuk ka jetesë
Asken kryqi nuk nxjerr në sherr
A janë kryq shtyllat me tel
Hapi krahët edhe kryq del
Horizontin don me matë
Vështro diellin dhe hape krahët
E kujton more zotni
Djathtas Jug, Majtas veri

E çdo gjadhesë si asht e gjallë
Me shumë kryq Zoti e ka falë
Veshe, sy, gojë e huna në ballë
Ti krah - hapun kryq a prët
Fminë e të dashun për lezet
E si do si të bahet puna
Kryq e puthë se s' të len huna
A shef pra more zotni
Veç kryq bahet dashuni
Mos i futni vedit zori
A asht kryq edhe avjoni
Të gjithë Haxhijë si në Meke shkojnë
Në bark të kryqit fluturojnë
Veni re në qielle me pa
A janë kryq shpent për hava
Po anija në det udhton
Me direkt e me tymon
Po makina vendit s' lot
Pa timon pa kollodok
Më kallzoni more miq
A janë kto t' gjitha kryq

Ti po deshte shif pa frik
Në shkollë pa kryq s' ka matematikë
Pa kryq s' mundet kure thret Ezanin
Kryq numron tespit Imami
Dhe nuk ka Mysliman të gjallë
Si pa kryq mundet me u falë
Po ushtari si vrojton
Objektivin kryq shenon
Pra ngado të shifni miq
Horizonti asht veç kryq
Pra askush t' mose mbaje merzi
Mbajeni n' qafe e vendosnje n' shpi
E kshu pra o miq e shoke
T' kallzon rrugën për Evropë!

RADHA E KOMUNIZMIT

Nji fmië 10 vjeçare
Po veshtronte një plak n' rrallë
Që ecte çale, çale!
Duke u terheq ngadale
T' mose humbiste rrallë

N' lufte plumba kishte marre!
Mbante pak mustaqe
Dy shenja kishte n' faqe!
Mbshtetun n' bastun qendronte!
Dhe fmija po e veshtronte!
E pyte nga dhembshurija
Kerkon t' dine hallin e tija!
Gjysh t' lutem t' pyse një fjale
Pse mosha e jote tash n' rrallë
A s ke njerez t' tjere valle?
Se ti je i moshuar
Krye e kame i sakatuem!
Dhe plaku e perkledhele
Dhe zemra i there!
Për pytjen e tije!
N' moshe aq i ri!
T' faleminers o bire
Se ti kenke djale i mire
Ofshine thelle dhe leshon një fjale!
Kam luftue t' qendroj n'rrallë!

Nosh Vuksani nga Italia

*** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi ***

SHKODRËS

Nuk harroj vendlindjen
Rodenjin dhe Përmenë
Por as ty moj Shkodra Loce
Se tek ty e kam follenë.

Kam dhimbje për vatanë
Kam mall’ për vajzë e djalë
Mezi pres t’ju ndodhem pranë
Që t’i puth e të shuaj mallë.

Kur mendoj për Shqipërinë
Sytë me lot më rrëkëllehen
Malli shtohet për shtëpinë
Mezi pres, aty të kthehem.

Pres të kthehem, Shkodra ime
Se tash jam në moshë të tretë
Veç aty ku kam follenë
Do ta ndjej veten të qetë.

Në follenë që përgatita
Kam gëzim e lumturi
Aty unë familjen ngrita
Trashëgova tre fëmi.

Shkodër, ti më mbajte ngrohtë
Dhe kur kish acar e ftohtë
Më rrethove me shoqëri
Me humor e dashuri.

Që nga Shkodra jon’ e lashtë
Nga qyteti me jehonë
Nipat tok më thërrasin
“Eja gjysh, sa s’është vonë”!

Do të kthehem pa vonesë
Tek folë e ngrohtësisë
Në qytetin ku do kaloj
Vitet e pleqërisë

Se aty dhe trotualet
Dhe rrugicat në qytet
Më duket se janë të mijat
Nëpër to shkova një jetë!

Përparim Hasani, Boston

FEMRA

Femra, në vizionin tim, është si një kështjelle
Që ti orvatesh ta "pushtosh"
Do mundohesh e do "luftosh", sa ...
Se leht këtë "kështjellë" nuk mund ta "rrëzosh".

Kjo "kështjellë" do marrë pak me "dredhira"
Se nuk shkon forca për të marrë një kështjellë të tillë.
Nuk prish më shumë punë suferina
Se sa një flladë që fryn si zefir.

Zefiri ka një temp e fryn ngadalë
Murrilani e suferina një çast e të trëmb
Forcë mos përdor (kam përvojë, se jam kokëbardhë)
Mos e trëmb një femër! Dhe mbaje mënd!

Se, nëse e trëmb, a përdor fuqinë
Betejën për ta marrë kështjellën e ke humbur
Mundohu të fitosh nga ajo simpatinë
Veç kështu për femrën je i "bukur".

Bukuria nuk është se shkon për djemtë
Por në sytë e femrës që të do, je i tillë
Për ç'shkruaj, zëre se kam "lincencë"
Femra do respektuar se është si xhevahir!

SHPESH ...

Shpesh me veten bëj vetgjyqësi
E marr veten si të pandehur!

-Pa ngreu e më thuaj:-A ke dëmtuar njeri?
Gjatë jetës me njerëzit si je sjellur?!
Dhe jam jo vetëm gjyqtar i drejtë, por dhe i rreptë
(Asnjë grimë nuk e fal dhe nuk mbaj anësi)
As që e lejoj të më mbajë ndonjë diçka të fshehtë
(Po ku ka të fshehtë që vetes nuk i di?)
E dëgjoj, tek flet, dhe zë mbaj shënim
Se jam moshatar dhe mund të harroj
Nëse ka nevojë për ndëshkim,
Me gjakftohëtësi zë e gjykoj.
Dhe ja ç'ka ndodhur gjatë vetgjyqësisë
Ja dhe "mëkatet" e mia:
I kam besuar veç dashurisë
Deri sa koka m'u mbulua me thija.
Asnjë njeri kurrë nuk lashë në baltë
Asnjë njeri kurrë nuk kam dëmtuar
Përkundrazi:me fjalën time jam bërë barikadë
Që IKSIN a Ypsilonin nga rreziku për ta shpëtuar.
Kurrë nuk e ktheva karriken e pushtetit,
Në trampolinë për të vënë pasuri
Nga unë duket ka anuar shpirti i poetit
Dhe jam mbushur veç me dashuri.

Dashuria për mua ka qenë reciproke
Dhe as e shtirur, dhe as me dhunë
Për ç'shkruaj, nuk ka vend për ekuivoke
Ata që më njohin, të flasin më shumë.

PËRSE E PI DUHANIN?

(Letër për një mike)
Po të ishe në Filipine,
Do të vriste diktatori DUARTJE!*

Më thuaj, e dashur mike,
Duhanin përse e pi? Përse?
Për fat të mirë, je në Shqipëri,
Dhe duhanin si plak tymos,
Mike, a s'më thua, duhanin pse e pi?
Të shoh dhe ky gjest më bën nervoz.
Duhani hiç nuk ta heqë stresin
Veç mushkëritë t'i mbulon me tym
Duhani, pas ca kohe, të sjellë kancerin
Dhe këtë ta jap me firmë.
Duhani të vret pak e nga pak
Çdo ditë e më shumë të helmon
Enkas për ty ky varg
Mike, duhanxheshë, më dëgjon?
* Pas drogmenëve do vrasë dhe duhanxhnjtë!

PUTHJE...

Puthje të "shtirur" kurrë nuk kam dhënë
Një puthje të ftohtë si buzëgjysheje!
As me dhunë s'kam puthur(sa për të qënë)
Se nuk më ka shije (pa si e pa qyshe?).
Puthja duhet të jetë e nxehtë - valë
Buza të më djegë dhe të më shijoj
Të më ketë atë kënaqësinë e puthjes së parë
Se, mbi të gjitha, atë puthje veçoj.
Puthja duhet të jetë si Rryma e Golfstrimit
Që shpirtin dhe zemrën të ma ngrohë
Oh, besojini ju Përparimit!
Unë puth veç miken që më do.
Pra, puthjen e shkëmbej recipropkisht,
Me miken që më falet pa kushte,
Do të pyesni: - Po tani që jam gjysh?
Shkoi e vate "koha ime" dhe për puthje.

MOS MË BUZËQESH!

(Dikujt që më hiqet si mik)
Mos më buzqesh, kur jemi ballas
(gjasma më do dhe më hiqesh si mik!!!)
Se unë nuk di që t'u vijë gjërave anës
Të njoh dhe e di mirë që je hipokrit!
Je si mësallë me dy faqe
Si maskë mbi fytyrë lëshon një buzëqeshje
Je si një klloun që jep shfaqje
Buzëqeshjen e shtirur ma ke si gërdheshje.

Sa more vesh që botova librin e parë
Më shmangeshe dhe zhdukeshe si hije
Ç'pate? O dyftytrësh krejt i shplarë.
Ç'pate? O URJAH HIP* hiporkizie?
As denjove që të më uroje
Ti që më hiqesh si mik
Mend plase zilisë, se dot nuk duroje
Se me shpirt e zemër je i lig.
* personazh negativ i Dikensit

Perparim Hysi

VOTO EDHE TI ...

Nisi fushata , nisi shamata,
Nuk dua gazeta, as televizor,
se çdo pushtetar më duket diktator,
Ka luajt nga mendja ky popull
kur e propozojn gomarin për deputet

O njeri i zgjuar. vjen pa më lajmeruar...
Sa shumë. më ke shqetsuar,
Ti vjen shumë shpesh.
e mendjen ma ban pshesh.
kur më flet në vesh.

Ti vjen e më thua prralla
i drejte është veç budalla
Të ndershmit si vjen kurre rralla
O njeri i zgjuar, i veshur bukur.
të lutëm ik ... , s' të kam hiç mik.
Ik o njeri ..., se ti fol kot.

Thua s' ka dashtni . thua s' ka as Zot,
Jam shumë i bindur normal nuk je,
Ti veç për pare jeton mbi dhe,
Ti nuk njeh ligje. as nuk njeh shtet,
kur kriminelin, quan mbret.

Ti nuk ke ndjenja ...as ke moral,
Unë ta kam frikën, prandaj më fal,
As unë s' po di . sesi është mire,
Kur gjërat që vlejn shiten krejt lire,
Kur e bukuria zhytet me balt,
Kur ka dal moda, me shit. m... për mjalt!?

KËTU VJEN ERA M ...!?

Rrugën time se fshi dot,
as vitet prapa dot si kthej,
Kam nis ta urrej të vërtetën,
qënka më mire nëse gënjej.

Ku lindim se zgjedhim dot,
jetojmë në vendin e gabuar,
Ku njerzit jane bërë djaj,
Ose Zoti na ka mallkuar!?

Do marr kravatën e dasmes,
nga deti të nxjerr "Titanikun",
Do ik të rrefehëm tëk burgu,
se Engjëjt nga këtu po ikun.

Do vë dhe unë një paruke,
të dukem kaçurrel si dikur,
Ketu të gjithë buzqeshin fallso.
S'ka mbet moral as kultur.

Në banjo se ndien erën e ...
Kur je larg hiqesh patriot,
Nëse e. sheh ne sy realitetin,
Të çmendur s'me quan dot.

Nuk po zë diellin me shosh.
Thjesht po shkruaj në errësirë,
Mësohu të jetosh me poshtërsinë,
Ose, Ose ik më mire....!

Lulash Brigja, 28 prill 2017

Bizneset e Ndue Ftonit në Michigan



REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi
Botimin:
NDUE FTONI

